



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

PROÇES-VERBAL MBI HARTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti : “Shërbime pritje/përcjellje ceremoniali për delegacione”

I mbajtur sot me datë **29.01.2026** , bazuar në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë **nr.72 datë 21.01.2026**, “ Për testimin e tregut, llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe marrjen në dorëzim” nga komisioni i përbërë nga z.Ervin Dizdari, specialist i sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse , znj. Melba Bizaku, specialiste pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit dhe Irma Sulishti, punonjese sekretarie e Keshillit Bashkiak, si personat përgjegjës mbi përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt **“Shërbime pritje/përcjellje ceremoniali për delegacione”**, në zbatim të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 2,”Dokumentimi i procesit” pika 2,shkronja a, neni 74 , pika 4”, Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik” Neni 36 ”Specifikimet teknike”.

Objekti kryesor i këtij prokurimi është organizimi i pritje-përcjelljeve në kuadër të bashkëpunimit me shtete të tjera, në nivel lokal, rajonal dhe më gjërë, në vendosjen dhe nxitjen e mëtejshme të bashkëpunimit midis qyteteve dhe partnerëve lokal, rajonal dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat, për zhvillimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe në kuadër të eksperiencave për arritjen dhe zhvillimin e kontakteve të krijuara nga përfaqësuesit tanë, kemi synuar arritjen e standarteve në nivele të përafërta me qytetet e tjera evropiane. Janë planifikuar për tu zhvilluar takime të ndryshme me qëllim forcimin e partneritetit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe përfaqësuesve të institucioneve homologe të nivelit lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, pjesëmarrës nga institucionet kulturore të ftuar për organizimin e aktiviteteve kulturore të ndryshme etj.

Specifikimet teknike janë përgatitur duke patur parasysh fondin që është vënë në dispozicion nga Bashkia Shkodër sipas VKB Nr.84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”.

Në përgatitjen e specifikimeve teknike janë marrë parasysh standartet HACCP (Hazard Analysis and Critical Control Points) dhe mënyja e ushqimeve për person(drekë /darkë) si më poshtë:

Antipastë e personalizuar

Tortino me patate dhe brokoli e shoqëruar me krem djathi të tymosur ose pulendër krokante me spinak të stufuar në tigan e shoqëruar me krem djathi

Pjatë e parë

1/2 Linguine me mish patë , purri dhe mente të freskët

1/2 Rizoto me boronicë dhe spek të tymosur ose Çorbe Shkodrane (Supe tradicionale me oriz , mish ,erza , veze dhe leng limoni)

Pjatë e dytë

Fileto viçi me piper jeshile dhe salcë demiglas ose mish viç ne saç

Shoqëruese

Patate furre

Embelsirë

Krem brule me shije vanilie ose musë maskarponeje me krem kafeje dhe biskot krambëll

Pije/person

0.25 lit. verë të kuqe ose të bardhë

0.5 lit. ujë natyral ose të gazuar

Kafe

Përgatitja në kuzhine e menysë së mësipërme duhet të bëhet duke përdorur tekniken e gatimit me temperature të ulët duke përdorur këto paisje bazë

1. Abatitor (Sipas normave HACCP)

2. Ronër (Për gatime më temperaturë të kontrolluar)

3. Makinë vakumi (Për paketimin hermetik të produkteve në bazë të normativave të HACCP)

Lokali duhet të ndodhet në qytetin e Shkodrës

Shërbimi do të kryhet gjatë vitit 2026 deri më 31.12.2026 sipas kërkesave të institucionit tone.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.si dhe me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.